



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:236776

Datë: 12.11.2021

Numri i dokumentit: 02393370

P. nr.536/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti I përgjithshëm- me Gjyqtaren Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit L. R. nga fshati . . .K.Istog, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.1358/2021 të datës 21.10.2021, për shkak të veprës penale, sulmi, nga neni 184 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhër ndëshkimor me datën **12.11.2021**, muarr këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1358/2021 të datës 21.10.2021, dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I A K U Z U A R I:

L. R., data e lindjes . . . në Shkup, e tani me vendbanim në fshatin . . .K.Istog, nga i ati S. dhe e ëma N., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal. . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datë 18.09.2021 rreth ores 17:00 në Rr. . . në Gjakovë, i pandehuri L. në gjendje të dehur prej 1.72 promila alkool në gjak, ka përdorë forcën ndaj tjetrit dhe atë ndaj të dëmtuarit Q. M., në atë mënyrë që ditën kritike derisa i dëmtuari ishte duke lëvizuar me biçikletë ndalet nga i pandehuri i cili fillimisht i drejtohet me fjalët “*çka po me kqyr*” e më pas të dëmtuarin me njëren dorë e kap për krahu ndërsa me dorën tjetër e kap për mustaqe duke e tërhequr e duke i thënë “*Ti pshurri mustaqet*“, mirëpo aty afër kanë qenë zyrtarët plicor të cilët menjëherë e kanë arrerstuar të pandehurin, me ç’ rast tek i dëmtuari ka shkaktuar dhembje dhe shqetësim.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale, sulmi, nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

-

Andaj, Gjykata komfor nenit 4,17.par.1,38,39,40,43,69,70 nenit 184 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 495 të KPPK-ës, të akuzuarit:

I SHQIPTON

Dënim me gjobë në shumën prej **500.-(pesëqind).-euro €**, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **25(njëzet e pesë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30.00(tridhjetë) euro**, e krejt këtë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari Q.M. M. nga Gjakova rr. “. . .”pn. kompensimin e dëmit mund ta realizonë në kontest civil

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP/II.nr.1358/2021 të datës 21.10.2021, kundër të akuzuarit L. R. nga fshati . . .K.Istog, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptojë dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-ës gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-ës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e Prokuroria Themelore –Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe ti shqiptoi ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 184 par.1 të KPRK-ës e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 1(një)vjet.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës, të cilat janë prova bindëse se ekziston dyshim i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, siç janë:

- Raporti i oficerit të Stacionit Policor në Gjakovë, A.T., i dt.18.09.2021;
- Deklarata e të dëmtuarit Q. M., e dhënë në Stacionit Policor në Gjakovë, me dt.18.09.2021.
- Deklarata e dëshmitares S. R., e dhënë në polici me dt.18.09.2021;
- Deklarata e të pandehurit L. R., e dhënë në në Stacionit Policor në Gjakovë, me dt.18.09.2021;
- Raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali Rajonal Isa Grezda në Gjakovë, në emër të dëmtuarit, me numër 15937 datë 18.09.2021;

-Alkool testi i datës 18.09.2021;
-Fotografit si dhe Shkresat tjera në lëndë.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-ës, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPK-se, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
-Departamenti i Përgjithshëm-
P. nr.536/21 më datë 12.11.2021**

**Procesmbajtësja
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarit të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merrë formë të prerë.

Numri i lëndës: 2021:236776
Datë: 12.11.2021
Numri i dokumentit: 02393370